



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.85/2019**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur përkitazi me apelin e Skender Alimetaj nga fshati Muzhevinë, Komuna e Istogut, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare që do të mbahen me 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.09.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet i pasafatshëm apeli** i identifikuar me numër: Anr.85/2019, i datës 24.09.2019, i paraqitur nga Skender Alimetaj, me të cilin ka kërkuar që të përfshihet në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës.

## A r s y e t i m

Me datë 24.09.2019 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Skender Alimetaj, në të cilin pretendon se i është mohuar e drejta për të votuar, pasi që të njëjtit iu është refuzuar kërkesa, për tu futur në listën e votuesve jashtë Kosovës. I njëjti thekson se në zgjedhjet nacionale të vitit 2014 ka votuar, ndërsa për këto zgjedhje ka aplikuar në përmes e-mail adresës së bashku me bashkëshorten, djalin dhe renë, ku sipas paraqitësit të apelit këta tre gjinden në listën votuese ndërsa emri i tij nuk figuron në këtë liste. Paraqitësi i apelit, ka bashkangjitur si dëshmi, e-mail adresën me formularin për aplikim si votues jashtë Kosove si dhe dokumentet e identifikimit. I njëjti kërkon nga PZAP-i, që t'i mundësohet përfshirja në listën votuese jashtë Kosovës.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së apelit, gjeti se:

### **Apeli është i pasafatshëm**

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të apelit, ka gjetur se apeli i paraqitur nga Skender Alimetaj nga fshati Muzhevinë, Komuna e Istogut, kundër vendimit të KQZ-së, është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar

me nenin 122 paragraf 1 të LZP-së, me të cilën përcaktohet se: “Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të KQZ-së, mund të apelojë atë vendim në PZAP, brenda (24) orëve”. Në këtë kuptim nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se periudha e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, ka filluar nga data 30.08.2019 dhe ka përfunduar me datën 10.09.2019. Vendimi i KQZ-së, për Certifikimin e Listës së Votuesve, është publikuar me datën 19.09.2019, ndërsa afati për apel ka qenë njëzetekatër (24) orë nga momenti i publikimit të vendimit të KQZ-së. Apeli në PZAP, është paraqitur nga apeluesi me datë 24.09.2019, që do të thotë se apeluesi apelin e ka parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 122 par.1 të LZP-së.

Nga arsyet e theksuara më lartë në kuptim të nenit 115 paragraf 1, dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 85/2019 me datën 25.09.2019



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.